



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 301/2 prot

Datë 08.02.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME.

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar ,”, me nr REF-85016-10-24-2023 me objekt” “**Loti 2 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Siemens /ose ekuivalent**” me fond limit 88,599,870.09 Lekë leke pa TVSH, zhvilluar me datë 30-11-2023 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Medfau” SHPK me Nipt J93610823R dhe adrese: *Lagja 5 Tiranë*
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.
Rruga e Dibres Nr. 372, Tirane
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “MSE” SHPK me Nipt L8201005A
Tirane Tirane TIRANE Rruga Diga e Liqenit, nr. pasurie 8/312, vol. 25, fq. 40, zona kadastrale 8270.

Në datën 07.02.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3792dhe me nr. 301/2024 prot., datë 07.02.2024 e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar ,”, me nr REF-85016-10-24-2023 me objekt” “Loti 2 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Siemens /ose ekuivalent” me fond limit 88,599,870.09 Lekë leke pa TVSH, zhvilluar me datë 30-11-2023 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Medfau” SHPK në ankesën nr. 301/2024 datë 07.02.2024 , pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “MSE” SHPK.

Kriteret dhe pretendimet.

1...? -2. 2. Shërbimi për ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet nga 2(dy) **Inxhinierë/Specialistë** të certifikuar dhe të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi.

2.....? Shtojca 7

SPECIFIKIMET TEKNIKE/TERMAT E REFERENCËS

Nevojat për organizimin funksional/strukturor të operatorit kontraktues dhe të ofrimit të shërbimit për mirëmbajtjen e plotë “**Full Risk**” të pajisjeve janë të grupuara në disa kategori, dhe janë të njëjta për çdo grupim në Lote.

- Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore

3.....?Mirëmbajtja parandaluese apo preventive të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet në **përputhje me rekomandimet e prodhuesit** përkatës për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetërimi apo përkeqësimi i performancës.

2. Shërbimi për ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet nga 2(dy) Inxhinierë/Specialistë të certifikuar dhe të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi.

3. Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes/ve dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet

Pretendimet:

[...] 3.....? Dokumentacioni tjetër është klasifikuar nga OE si konfidencial. Nuk e di nëse mundet të quhet Konfidenciale deklaratat standarte dhe deklaratat që kerkohen sipas DST, si mundet të konsiderohet si konfidenciale Sigurimi i Ofertes, si mund të konsiderohet konfidenciale certifikatat e Trajnimit . Lutemi KPP që të kryejë verifikimin e këtyre dokumentave që ka paraqitur kompania MSE.

4....? Duke parë faqen e APP shikojme që kjo kompani MSE ka marrë pjesë në të gjitha lotet e mirëmbajtjes në QSUT, SIEMENS. PHILIPS DHE TOSHIBA. Me të drejtë në si përfaqesues të kompanisë SIEMENS me një eksperiment mbi 20 vjetecare nuk arrijmë dot të kuptojmë se si kjo kompani si MSE e themeluar në vitin 2018 mundet të ketë fuqinë për realizimin me sukses të këtyre mirëmbajtjeve të pajisjeve mjekësore.

5.....? Duke qenë në një situatë të sa përmendur më lart propozimi ynë për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve mjekësore shumë të rëndësishme për pacientet kompania MEDFAU si përfaqesues i SIEMENS kemi prozuar një ofertë integrale ku pajisjet e lartpërmendura të cilat kanë mbi 10 vjet të prodhuara të behet një kontratë shërbimi ku të përfshihen vetëm oret e punës, praktikë kjo e aplikuar nga AK Qendra Spitalore Universitare Nene Teresa edhe në rastet e ngjashme sic ka qenë kontrata për mirëmbajtjen e MR (Rezonance Magnetike) GE e instaluar në shërbimin e Neurologjisë ?.etj.

6.....? Autoriteti Kontraktor Qendra Spitalore Universitare Nene Teresa duhet të verifikojë vertetesinë e dokumentacionit të paraqitur nga kompania MSE në këtë procedurë prokurimi duke kontaktuar kompaninë SIEMENS. Detajet e kontaktit të personit si më poshtë[...]

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 08.02.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri